



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 522 Prot.

Tiranë, më datë 29 . 08 .2025

VENDIM

Nr. 472, datë 29.08.2025

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të Projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 29.08.2025:

VENDOSI

- Miratim për projektin kërkimor shkencor në vazhdim “Tempulli i Shtyllasit - arkitektura dhe rivlerësime arkeologjike”, me aplikues dhe zhvillues **Instituti e Albanologjisë, me rekomandimet:**
 - Instituti i Arkeologjisë të caktojë një bashkëdrejtues të ri nga pala shqiptare, si dhe të njoftohet IKTK dhe Parku Arkeologjik Apoloni – Bylis për bashkëdrejtuesin e ri të këtij projekti, para fillimit të punimeve;
 - Fushata e përcaktuar për vitin 2025 në kuadër të projektit “Tempulli i Shtyllasit - arkitektura dhe rivlerësime arkeologjike” do të jetë njëkohësisht edhe viti i fundit i tij, pa të drejtë rinovimi të lejes për hulumtime arkeologjike;
- Para fillimit të projektit të bëhet njoftim zyrtar pranë IKTK-së dhe DRTK-së përkatëse;
- Pas përfundimit të projektit, një kopje e dokumentacionit si dhe lista e gjetjeve arkeologjike të depozitohen pranë IKTK-së, DRTK-së dhe IKRTK-së;
- Dokumentacioni i hartuar në kuadër të këtij projekti të dorëzohet pranë IKTK-së;
- Afati i përfundimit të punimeve do të jetë sipas planit të punës të depozituar në IKTK;
- Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
- Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Joli MITROJORGJI

